



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:263277
Datë: 01.12.2020
Numri i dokumentit: 01310171

A.nr.248/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe procesmbajtësen Sanije Salju, në konfliktin administrativ të paditësit K. S., të cilin me autorizim e përfaqëson A. Q., avokat nga P., kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me seli në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative, pas seancës së shqyrtimit kryesor publik, me datën 02.11.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K. S. nga Prishtina dhe ANULOHEN vendimet e të paditurës me Nr. 06/2013 i datës 05.06.2013, vendimi Nr. 6/4-3007 i datës 06.06.2013 si dhe vendimi i datës 28.02.2017 pa numër reference.

II. OBLIGOHET e paditura që paditësit K. S. t'i njeh gradën profesionale "*Juris Doctor*", studime tre vjeçare e lëshuar nga Widener University, Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vlerën ekuivalente 8 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

III. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar.

IV. Në lidhje me kërkesën për kompensimin e dëmit, paditësi udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e datës 09.02.2017 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.10.2020, ka kërkuar nga gjykata që të nxjerr vet aktin të cilin nuk e ka nxjerrë e paditura, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në padinë e tij, paditësi pohon se me Aktgjykimin A.nr. 1248/13 të datës 13.12.2016, Gjykata Administrative ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka urdhëruar MASHT-in që të zbatoj këtë Aktgjykim në tërësi jo më vonë se 30 ditë nga data e Aktgjykimit. Përkundër karakterit të obligueshëm të këtij Aktgjykimi për MASHT-in sipas nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, MASHT nuk ka zbatuar këtë Aktgjykim dhe urdhër të Gjykatës Administrative në afatin ligjor 30 ditor. Poashtu e paditura nuk ka parashtruar as ankesë ndaj

Aktgjykimit të lartpërmendur me ç' rast është pezulluar obligimi i të paditurës për të respektuar këtë vendim Gjykate. Më tutje pohojnë se si të autorizuar të paditësit kanë parashtruar kërkesë në afatin shtesë 7 ditor duke kërkur nga MASHT, përkatësisht NARIC nxjerrjen e një Vendimi për rastin e paditësit që është në përputhje të plotë me aktgjykimin në fjalë dhe urdhërat që i përmban ky Aktgjykim.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, i autorizuari i paditësit deklaroi poashtu se: *“paditësi me dt.09.02.17 ka parashtruar padi në konfliktin administrativ për shkak të heshtjes administrative. Kushtet ligjore për parashtrimin e padisë për shkak të heshtjes administrative më hollësisht janë përshkruar në padi. Në përgjigjen në padi organi i paditur thekson se në ndërkohë përkatësisht në periudhën kohore prej dorëzimit të padisë e deri në caktimin e shqyrtimit gjyqësor Këshilli Shtetëror për Njohje ka vendos që gradën “Juris doctor” të Z.K. S. ta njoh si gradë të nivelit të shtatë sipas kornizës kombëtare të kualifikimeve.*

Më tutje thuhet se ky vendim është nënshkruar nga D. K. kryesuese e Këshillit Shtetëror për Njohje. Duke pas qasje për vendimin e cekur më lartë i cili i është bashkëngjitur përgjigjes në padi kemi vërejtur se i njëjti nuk është i nënshkruar është i pa protokolluar e po ashtu në te ka ndërhyrje të pa zakonta me dorëshkrim në pjesën e dispozitivit dhe arsytimit. Për rrjedhojë në mungesë të nënshkrimit dokumenti i quajtur “vendim për plotësimin e vendimit” nr.6/4 – 3007 të dt.06.06.13, i cili ndodhet në shkresat e lëndës është absolutisht i pa vlefshëm, prandaj nuk mund të shërbejë si bazë për vendimmarrje nga ana e gjykatës. Marrë parasysh faktit se vendimit të cilit i referohet e paditura është absolutisht i pavlefshëm konsiderojmë se sërish ndodhemi para heshtjes administrative.

Në lidhje me argumentet juridike në mbështetje të kërkesëpadisë i referohemi të gjitha argumenteve të paraqitura në padinë e dt. 19.09.13 e sidomos pjesës arsytuese të aktgjykimit A.nr.1248/13 f.4 në të cilin gjykata shprehet si në vijim: “mbi këtë gjendje të fakteve kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative – juridike është shkelur ligji në dëm të paditësit, andaj organi i paditur do të ketë parasysh theksimet nga ankesa e paditësit, do të vërtetoi faktet relevante duke marrë në konsideratë obligimin për ta klasifikuar edhe nivelin e gradës profesionale (në këtë rast me 8) siç vërtetohet me njoftimet nga WIDNER UNIVERSITY të dt.15.11.12 dhe 02.05.15, e pastaj në afatin prej 30 ditëve të marrë vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nuk ka dilemë se gjykata e ka detyruar MASHT që nivelin e gradës profesionale të Z.S. ta njohë si gradë e nivelit 8, por siç po vërehet ky qëndrim i gjykatës nuk është marrë parasysh nga e paditura. Në lidhje me kërkesën për shpërblimin e dëmit e cila është parashtruar përmes precizimit të padisë me dt.09.03.17 theksojmë se pajtohemi që gjykata ta udhëzoj paditësin në kontest civil nëse trajtimi i kërkesës për shpërblimin e dëmit do të merrte kohë të konsiderueshme.”

E paditura me përgjigjen në padi të datës 04.09.2019 pohon se Z.K. S. me dt.19.10.12 ka aplikuar në divizionin për Njohje, Barasvelrë dhe Informim Akademik “Naric Kosova” për njohjen e gradës “Juris Doctor” të fituar në Widener University, SHBA. Me datë 05.06.13 komisioni profesional i ekspertëve pas shqyrtimit të dokumentacionit të palës dhe përgjigjeve zyrtare të pranuar nga autoritetet relevante të SHBA-së si ENIC NARIC (Departamenti i Shtetit të Edukimit) i ka propozuar Këshillit Shtetëror për Njohje që gradën “Juris Doctor” ta njeh si ekuivalente me gradën “Jurist i Diplomuar” e cila fitohet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”. Komisioni profesional i ekspertëve ishte i përbërë nga: Prof.dr. Abdulla Aliu, Prof.dr. Mejdi Bektashi dhe Z.Gjylbehare Llapi përfaqësuese nga MASHT. Me dt.06.06.13 Këshilli Shtetëror për Njohje ka marrë vendim për njohjen e gradës në fjalë.

Poashtu sipas UA16/16 në rast të mos përputhjes së përgjigjeve të të dy institucioneve (Universitetit në SHBA dhe Enic Naric në SHBA ose Departamentit të Arsimit të SHBA) sipas nenit 7 par.4, e vlefshme për NARIC (QKNJLA) në Kosovë është përgjigja e institucionit më të lartë ENIC NARIC në SHBA apo e autoritetit përkatës sipas pikës 5 neni 7. Pohon gjithashtu se janë bërë kërkime edhe në faqet zyrtare si nga: Departamenti i Edukimit U.S që konsiderohet organi më i lartë sipas UA16/16.

Pas marrjes së këtij vendimi, Z. K. S. është ankuar ku më pas komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në MASHT, në funksion të zbatimit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e ka obliguar Këshillin Shtetëror për Njohje që të rishqyrtoj kërkesën e K. S.t. Këshilli Shtetëror për Njohje në zbatim të vendimit të komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në MASHT, me dt.28.02.17 e ka shqyrtuar lëndën dhe duke u bazuar në informatat zyrtare dhe dosjen e parashtruesit të kërkesës ka vendosur që gradën “*Juris Doctor*” të Z.K. S.t, ta njohë si gradë të nivelit të 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Në parashtrësën e datës 27.10.2020 ashtu sikurse edhe në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesja e të paditurës deklaroi se: *“po filloj së pari me sqarimin për gradën JD të fituar në SHBA. Unë e lexova me kujdes padinë e paditësit dhe sa i përket njohjes së gardës Juris doctor përgjigja është për sa vijon: padia e paditësit është e pa argumentuar dhe e pa themeltë dhe si e tillë duhet të hidhet poshtë sepse nuk ka asnjë bazë ligjore për tu pranuar si e tillë. Padia ngërthen në vete shumë paqartësi dhe të pa vërteta edhe atëherë kur paditësi i është referuar dokumenteve zyrtare, janë shtrembëruar faktet për të përfitur nga këto të dhëna. Krejt kjo që të përfitoi një gradë shkencore të cilën në fakt nuk e zotëron në bazë të dokumentacionit. Paditësi kur thirret në atë se i është mohuar e drejta për të qenë profesor, kjo nuk ka asnjë vlerë për të paditurën sepse ne nuk kemi të bëjmë aspak me këtë çështje si palë e paditur. Tërë thelbi i kësaj çështje është fakti se i padituri kërkon që ti njihet grada PHD. Kjo është e pamundur sepse do të ishte shkelje ligjore që një gradë e fituar në SHBA në fushën e drejtësisë, që është fjala për gradën JD e që në SHBA është niveli i parë i shkollimit në fushën e drejtësisë të ekuivaldohet në gradën e PHD kur dihet se niveli i JD është doktoraturë shkencore.*

Pala paditëse i ka bashkëngjitë komunikimin me padi që ka pas në universitetin ku e ka fituar gradën JD dhe nuk mund të thirret në fakt sepse nuk është universiteti i cili ka tagrin që të bëjë ekuivalencën e titullit shkencor, ose edhe të jap sqarime shtesë se si duhet trajtuar një lëndë nga e paditura, ndërsa është e qartë dhe vërehet sqarimi i detajuar që Z.Rafael Nevarez nga Departamenti i Edukimit në SHBA, përveç sqarimeve që ia ka dhënë Narikut i ka kthyer në përgjigje paditësit ku ndër të tjera thekson se në SHBA mund të jap mësim në Universitet në këtë gradë, është fjala për gradën JD, mirëpo në asnjë moment nuk thotë se grada JD është ekuivalente me gradën PHD, kjo sepse grada JD nuk është doktoraturë shkencore dhe nuk mund të trajtohet si e tillë. Titulli JD i fituar nga paditësit po theksoi edhe emrin K. S. është niveli i parë i studimeve në fushën e drejtësisë në SHBA. Për ta bërë më të qartë për ju i nderuari gjyqtar niveli i shkollimit në fakultete ose shkolla juridike në SHBA është i organizuar në këtë formë.

JD është niveli i parë i studimeve në fushën e drejtësisë e që është ekuivalent me nivelin e parë të studimeve bachelor i drejtësisë në Kosovë. L.L.M ose master i drejtësisë që është niveli i dytë i studimeve në fushën e drejtësisë në SHBA e që është ekuivalent me titullin master i drejtësisë në Kosovë po ashtu edhe në Evropë.

S.J.D. ose J.S.D ose doktor i shkencave juridike në SHBA ose ekuivalent me gradën JD në Kosovë në këtë rast. Mirëpo që paditësit ti njihet grada JD si PHD është vërtetë e pakuptueshme sepse JD përkon ose është ekuivalente me gradën bachelor i drejtësisë sepse grada JD është nivel i parë i studimeve në fushën e drejtësisë në SHBA. Në mënyrë që paditësit ti ekuivalentohet me gradën JD paditësi do duhej të kishte fituar gradën S.J.D e për të fituar këtë gradë duhet që pas gradës JD të fitonte L.L.M e në fund S.J.D. ose J.S.D.

Për koeqidencë të rastit edhe universiteti ku pala paditëse i ka fituar studimet në SHBA e ofron shkollimin për gradën S.J.D që është nivel i lartë i studimeve në fushën e drejtësisë, pra doktor i shkencave juridike dhe ekuivaldohet me JD të fituar në Kosovë dhe Evropë. Do të thotë në këtë link të cilin e kamë në dosje mund të shihen të gjitha të dhënat të cilat nuk po i lexoi edhe njëherë. Para se me kaluar në procedurat administrative që veç i theksoi avokati, pasi që këtu jam direkt me i dhënë sqarimet sidomos sqarimet me gradën JD dhe nivelet tjera në rast dmth.pa qartësive dhe duhet ndonjë sqarim shtesë ne mund të propozojmë ekspert të fushës të cilët do të mund të ofronin edhe më tepër sqarime në lidhje me këtë rast. Pra për këto arsyeja të cekura më lartë kjo padi nuk ka bazë dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në lidhje me parregullsitë procedurale në vendimi e dytë të të paditurës deklaroi se: si rregull një vendim i lëshuar nga këshilli shtetëror për njohje pasi që të nënshkruhet dërgohet në arkivin e MASHT ku më pas dmth.nga momenti që e tërheq pala dhe e nënshkruan që e tërheq edhe arkiva e vendos numrin e protokollit, pala e merr vendimin dhe nënshkruhet. Si rregull vendimet nuk guxojnë të kenë ndërhyrje me laps kimik aq më pak të mos jenë të nënshkuara.

Në lidhje me dekalrimet e të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit replikoi duke thënë se: “fillimisht deklaroi se përfaqësuesja e të paditurës nuk ia doli që të jap arsyetime valide në lidhje me faktin se pjesë e shkresave të lëndës është një vendim i të paditurës i cili është i pa nënshkruar i pa protokolluar dhe i pa vulosur. Këtë vendim si provë e ka bashkëngjitur vetë e paditura, prandaj ky vendim duke qenë se nuk i ka elementet qenësore të një akti administrativ ky vendim duhet të konsiderohet si i pa vlefshëm. Po ashtu theksoi se deklaramet e palës së paditur ish in jashtë petitumit të kërkesëpadiisë. Me kërkesëpadi nga paditësi është kërkuar në mënyrë taksative që të vërtetohet se garda shkencore e paditësit “Juris Doctor” është e nivelit 8 sipas sistemit evropian të kualifikimeve, pra është kërkuar të njihet niveli e nuk është kërkuar që të njihet grada PHD ashtu siç e thekson pala e paditur.

Në lidhje me deklarametin e palës paditëse për emalin e dërguar nga Z.Rafael Nevarez theksoi se deklarimi ishte jo korrekt dhe i njëanshëm për faktin se Z.Nevarez në emalin e dt.06.02.13 në mënyrë taksative thekson se titujt J.D dhe PHD duhet të konsiderohen tituj ekuivalent për qëllime të punimit të punësimit arsimor, këtë fakt nga ky emal pala e paditur fare nuk e theksoi.

Nëse titulli J.D konsiderohet kualifikim fillestar i një juristi apo gradë bachelor atëherë shtohet pyetja si ka mundësi që si kusht për të regjistruar fakultetin i cili ofron gradën JD është që aplikuesi të ketë të përfunduara studimet 4 vjeçare paraprake para Juris doctor, në SHBA juristi beachelor e ka thirrjen e L.L.B e jo J.D.

Pala e paditur iu referuar edhe faktit se Universiteti WIDENER tash më ofron edhe gradën e S.J.D e cila është ekuivalente me P.H.D mirëpo nuk ofroi asnjë dëshmi se grada S.J.D të jetë ofruar edhe në kohën kur paditësi i ka përfunduar studimet.

Sa i përket propozimit për ekspertizë gjykata nuk angazhon ekspert me interpretuar ligjin, e po ashtu ekzistojnë pengesa procedurale për angazhimin e ekspertizës sepse bazuar në dis.të LPK-së të cilat me analogji zbatohen edhe në procedurën e konfliktit administrativ propozime për prova duhet të jepen në seancën përgatitore, ndërsa ne jemi në shqyrtimin kryesor.”

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit dekalroi se: *“mbes në tërësi pranë thënieve nga padia e parë dhe e dytë dhe po ashtu mbes në tërësi pranë thënieve nga seanca përgatitore dhe në shqyrtimin gjyqësor me kërkesën që gjykata ta aprovon padinë dhe kërkesëpadinë si të bazuar”.*

Përfaqësuesja e të paditurës në fjalën përfundimtare deklaroi: *“mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe në deklarimet në seancën e shqyrtimit përgatitor dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor duke kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pabazuar”.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13.10.2020, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë:

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë me A.nr.1248/13 i dt.13.12.16, kërkesa e paditësit drejtuar Qendrës Kombëtare për Njohjen e Diplomave, me nr.prot.431 e dt.31.01.17, aplikacioni i paditësit për njohje të diplomës Juris Doctor nga SHBA me nr.prot.5012 idt.12.10.12, kërkesa për nostrifikim të diplomës Juris doctor të paditësit me nr.prot.2906 e dt.05.06.13, vendimi i M. Arsimit r.6/4-3007 i dt.06.06.13, ankesa ndaj vendimit nr.6/4 – 3007 të K. Kombëtar për Njohje me nr.prot.3007 e dt.19.06.13, komunikimi elektronik dhe emali i personit Rafael Newarez i dt.18.06.13, ora 05:20 e mbrëmjes, kërkesa e përsëritur për shqyrtim të ankesës me nr.prot.3007 e dt.20.08.13, letra e lëshuar nga WIDENER UNIVERSITY dt.15.11.12, diploma e lëshuar në emër të paditësit K. S. me të cilën i njihet grada e Juris Doctor e cila e mbanë dt.15.05.2004, dokumenti material me nr. regjistrin 558/12 i cili e vërteton kopjen e diplomës, diploma e përkthyer në gj. Shqipe e lëshuar nga WIDENER UNIVERSITY me të cilin paditësit i njihet titulli Doctor i Jurisprudencës dhe e cila e mbanë dt.15.05.2004 nga përkthyesi i autorizuar gjyqësor Avni Rustemi, përkthimi në gj. Shqipe i letrës së dërguar nga WIDENER UNIVERSITY respektivisht zyrtarja Tamara L. Graham e dt.15.11.12, letra origjinale dhe përkthimi i krye sekretares Tamara L. Graham së WIDENER UNIVERSITY drejtuar zyrtareve të qendrës Naric i dt.02.05.13, komunikimi elektronik në mes të Refail Navares te bërë me zyrtaret Naric i dt.06.02.13, vendimi i Universitetit të Prishtinës me nr.1/537 i dt.21.05.2009, për zgjidhjen e paditësit prof. asistent, njoftimi për konkursin për zgjidhjen e personelit akademik në fakultetet e UP “*Hasan Prishtina*” dt.28.05.13, kontrata e punës e paditësit me nr.prot.2/656 e dt.28.09.12, vendimi për plotësimin e vendimit nr.6/4 – 3007 të dt.06.06.13.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditësit lidhur me kërkesëpadinë e tij dhe gjeti se padia është e bazuar.

Gjykata gjeti se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi kishte aplikuar për njohje të diplomës së tij “*Juris Doctor*”. Gjithashtu nuk është kontestuese se e paditura kishte marrë vendim që paditësit gradën “*Juris Doctor*” të fituar në Widener University në ShBA ia kishte baras vlerësuar me gradën 6 respektivisht me nivelin e kualifikimit “*Jurist i diplomuar*”.

I pa kënaqur me këtë vendim paditësi bënë ankesë në komisionin për shqyrtimin e ankesave në kuadër të MASHT i cili pas shqyrtimit të ankesës merr vendim të ri me të cilin paditësit i nje

gradën e nivelit 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe e cila është e barasvlefshme me nivelin e studimeve master në Kosovë.

I pa kënaqur me këtë vendim paditësi bënë ankesë kundër këtij vendimi me ç'rast nuk merr përgjigje dhe me padinë nën shenjën A.nr.1248/13 të dt.19.09.13 e konteston tërë procedurën administrative dhe hapat e ndërmarrë si dhe hapat e pa ndërmarrë nga ana e të paditurës në lidhje me njohjen e diplomës së tij me nivelin 8 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Në lidhje me pretendimet e paditësit të shprehura në këtë padi, Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin e dt.13.12.16 kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit K. S. dhe kishte urdhëruar të paditurën që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi të merr aktvendim sipas anekses së paditësit nr.3007 të dt.19.06.13, të parashtruar kundër vendimit nr.4/4 – 3007 të dt.06.06.13 dhe aktvendimin t'ia dorëzoi paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Gjykata gjeti se e paditura nuk kishte respektuar asnjëherë këtë aktgjykim të gjykatës, as në afatin 30 ditor të përcaktuar nga gjykata e as në afatin e mëtejme prej 7 ditësh, ashtu siç kishte kërkuar me parashtrësë të veçantë paditësi. Në këtë mënyrë e paditura kishte rënë në heshtje administrative.

Me padinë e datës 09.02.2017, duke qenë se e paditura nuk kishte zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore me të cilin paditësit i ishte aprovuar padia, paditësi kërkon nga gjykata që vet të nxjerrë aktgjykimin i cili do ta zëvendësoj aktin administrativ që nuk është nxjerrë asnjëherë nga e paditura.

Me parashtrësën e datës 09.03.2017 përfaqësuesi i paditësit e plotëson padinë edhe më tej duke kërkuar që përpos 4 pikave të petitumit të përshkruara në padi ti shtohet edhe pika 5 ta detyroj të paditurën që në emër të kompensimit të dëmit material dhe moral t'ia paguaj paditësit shumën e cila do të caktohet nga eksperti. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Sidoqoftë përfaqësuesi i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor kërkoi nga gjykata që në lidhje me kërkesën për shpërblimin e dëmit e cila është parashtruar përmes precizimit të padisë me dt.09.03.17 theksojnë se pajtohen që gjykata ta udhëzoj paditësin në kontest civil nëse trajtimi i kërkesës për shpërblimin e dëmit do të merrte kohë të konsiderueshme.

Gjykata gjeti se me njoftimin e bërë nga kryesekretarja Tamara L.Grahan nga Widener University që mbanë datën 02.05.2013 dhe e cila i drejtohet zyrtares nga Qendra Naric Mimoza Morina konfirmohet se diploma "*Juris Doctor*" klasifikohet me nivelin 8 sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Gjykata poashtu gjeti se paditësi me të drejtë kërkon që ti njihet diploma e *Juris Doctor* si doktoratë profesionale dhe këtë e vërteton edhe njoftimi zyrtar nga Z.Rafael Nevarez i cili ndër të tjera pohon se kërkesat apo kriteret për tu pranuar në shkollën juridike ndryshojnë nga institucioni në institucion por një diplomë e bachelorit përgjithësisht është e nevojshme për tu

pranuar në shkollën juridike. Në këtë kuptim gjykata gjeti se paditësi nuk do të mund të përfundonte studimet 3 vjeçare dhe të fitonte gradën *Juris Doctor* pa përfunduar paraprakisht studimet bachelor.

Përmes këtij njoftimi nga Z.Rafael Navarez, gjykata erdhi në përfundim se diploma *Juris Doctor* është diplomë profesionale me çka hodhi poshtë pretendimet e të paditurës e cila diplomën *Juris Doctor* nuk e njeh si doktoratë profesionale.

Poashtu gjykata konfirmoi se diploma *Juris Doctor* e paditësit duhet të barasvlerësohet me nivelin 8 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve si dhe sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe se në këtë përfundim gjykata erdhi edhe me konfirmimin e emailit të dt.15.05.12 të Z.nj.Tamara Graham me të cilën duke iu drejtuar zyrtares Qamile Sinanaj, në atë kohë udhëheqëse e Qendrës Narik edhe njëherë konfirmon se diploma *Juris Doctor* konsiderohet diplomë profesionale dhe si e tillë klasifikohet me nivelin 8 sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Gjykata mori në konsideratë të gjitha pretendimet e përfaqësueses së të paditurës dhe për të njëjtat erdhi në përfundim se janë të paargumentuara, të paligjshme dhe të pambështetura në fakte apo në të drejtën materiale.

Gjykata analizoi me kujdes pretendimin dhe kërkesën e përfaqësueses së të paditurës se nga paditësi janë shtrembëruar faktet për të fituar nga këto të dhëna. Në këtë kuptim përfaqësuesja e të paditurës as në përgjigje në padi, as në parashtrësën e datës 27.10.2020 dhe as në shqyrtimin gjyqësor nuk arriti që gjykatës t'ia dokumentoj një për një se cilat fakte janë shtrembëruar dhe pse padia e paditësit në pikëpamje të të paditurës është e pa argumentuar dhe e pa themeltë.

Gjykata poashtu hodhi poshtë pretendimet e përfaqësueses së të paditurës se Universiteti ku ka diplomuar paditësi nuk mund të jap sqarime shtesë në lidhje me këtë çështje, duke ardhë në përfundim se komunikimi me Universitetin në fjalë jo vetëm që ishte i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të sqaruar çështjet kontestuese, por se pikërisht komunikimi me Universitetin është praktikë që e bënë edhe vetë e paditura gjatë procesit të njohjes së diplomave të huaja dhe se në pikëpamje të kësaj çështje ky pretendim i palës së paditur u hodh poshtë nga gjykata.

Gjykata e vlerësoi gatishmërinë e përfaqësueses së të paditurës në lidhje me nivelet e studimeve në fushën e drejtësisë në Amerikë, por që për të njëjtat konstatoi se nuk ka ofruar asnjë relevancë apo ndërlidhshmëri me çështjen juridike që është objekt i këtij konflikti administrativ.

Gjykata poashtu analizoi pretendimet e përfaqësueses së të paditurës në lidhje me interpretimin e dërguar nga Z.Rafael Navarez dhe se në lidhje me interpretimin e përfaqësueses së të paditurës bërë këtij njoftimi nga Z.Nvarez gjykata erdhi në përfundim se pretendimet e të paditurës së paditësit nuk mund ti baras vlerësohet grada *Juris Doctor* me nivelin 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, janë pretendime subjektive, të pa mbështetura në lidh dhe fakte, të pa argumentuara dhe jo objektive.

Në lidhje me çështjen e vendimit të MASHT i dt.28.02.17 pa numër reference me të cilën plotësohet vendimi nr.6/4-3007 të dt.06.06.13, gjykata gjeti se i njëjti nuk i plotëson kushtet formale ligjore të një akti administrativ për arsye se i njëjti është i përfshirë në shkeljet thelbësore të Ligjit për Procedurën Administrative, konkretisht të nenit 47. Meqenëse i njëjti nuk përmban numër, dispozitivi është i paqartë, ndërkaq në pjesën arsyetuese është ndërhyrë në formë fizike duke e bërë arsyetimin e pa qartë dhe kontradiktor me dispozitivin, për më tepër vendimi nuk është i nënshkruar nga personi i cili supozohet ta ketë marrë atë. Pavlefshmërinë absolute të këtij vendimi e vërtetojnë edhe deklaratimet e përfaqësueses së të paditurës në seancën e shqyrtimit gjyqësor e cila ndër të tjera thotë se: si rregull vendimet nuk guxojnë të kenë ndërhyrje me laps kimik aq më pak të mos jenë të nënshkruara. Mos njohuria e përfaqësueses së të paditurës në lidhje me atë se si është lëshuar ky vendim dëshmon gjithashtu se e paditura nuk ka respektuar kushtet formale të lëshimit të këtij vendimi.

Gjykata mori parasysh gatishmërinë e përfaqësueses së të paditurës në lidhje me angazhimin eventual të një eksperti të fushës i cili do të ofronte sqarime më të detajuara në lidhje me këtë çështje juridike, mirëpo konstatoi se një gjë e tillë nuk është e nevojshme pasi që gjykata vetë sipas detyrës zyrtare është e obliguar që të zbatoi ligjet të cilat janë në fuqi, ashtu që angazhimi i një eksperti për të sqaruar apo interpretuar ligjet në fuqi është i padobishëm dhe i panevojshëm.

Gjykata gjeti se propozimi i përfaqësuesit të paditësit në lidhje me kompensimin e dëmit të paditësit nga e paditura dhe propozimin që paditësi të udhëzohet në kontest të rregullt civil është propozim i drejtë. Për këtë arsye gjykata vendosi që paditësin për realizimin e kërkesës për kompensimin e dëmit ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko-civil.

Vendimi në lidhje me shpenzimet procedurës u mor në bazë të nenit 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 46, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.248/17, datë 02.11.2020

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçi

Numri i lëndës: 2019:263277
Datë: 01.12.2020
Numri i dokumentit: 01310171

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj gjykate.